REPUBLIKAE SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 3628 prot.

Lushnjë më, 16/04/2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

" MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT KULTUROR DHE RINOR " MISS LUSHNJA 2026 ".

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltarë!

Ky relacion ju paraqitet për miratimin e përdorimin të fondit rezervë të institucionit të Bashkisë Lushnjë, në mbështetje të realizimit të projektit kulturor dhe rinor "Miss Lushnja 2026".
Ky projekt, i propozuar nga Shoqata Kulturore "SKAMPA" (OJQ), përfaqëson një nismë me vlera duke synuar organizimin e një aktiviteti kulturor, artistik dhe rinor me pjesëmarrjen e vajzave të moshës 15–20 vjeç.
"Miss Lushnja 2026" nuk është thjesht një event, por një platformë që i jep zë dhe mundësi brezit të ri për të shprehur potencialin, talentin dhe aspiratat e tyre.

Duke iu referuar suksesit të edicionit të vitit 2025, i cili solli përfitime konkrete për vajzat pjesëmarrëse si bursa studimi, mundësi bashkëpunimi profesional dhe promovim të vlerave rinore, vlerësojmë se vijimësia e këtij projekti është një investim i rëndësishëm në zhvillimin social dhe kulturor të qytetit.

Në këtë kuadër, organizatorët kanë paraqitur kërkesë për mbështetje financiare në vlerën 1,000,000 (njëmilion) lekë, fond i cili do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve organizative,

komponentët artistikë dhe logjistikën e nevojshme për zhvillimin me cilësi të aktivitetit (kërkesa dhe projekti bashkalidhur).
Mbështetja e Bashkisë Lushnjë në këtë projekt nuk përbën vetëm një kontribut financiar, por një akt besimi dhe mbështetje ndaj aktiviteteve lokale.

Për këto arsye, propozohet miratimi i përdorimit të fondit rezervë në shumën 1,000,000 (njëmilion) lekë për mbështetjen e projektit "Miss Lushnja 2026".

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa



Adresa:Lagjja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 222139 Email:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr. 3628/1 **Prot.** **Lushnjë, më** 16/04 **/ 2026**

PROJEKT-VENDIM

NR. 41 **DATË** 16 / 04 **/2026**

" MBI PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT KULTUROR DHE RINOR " MISS LUSHNJA 2026 ".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ____/____/2026, mbështetur në relacionin e paraqitur nga administratë e Bashkisë për " Përdorimin e fondit rezervë për realizimin e projektit kulturor dhe rinor " Miss Lushnja 2026 " si dhe në mbështetje të nenit 54 shkronja "m" të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar.Neni 6 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 " Për menazhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.Pika 132 e Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave " Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".Ju:

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë dhe Projektin Kulturor dhe Rinor "Miss Lushnja 2026 "
2. Të miratojë fondin 1.000.000 (njëmilion) lekë për realizimin e projektit për Shoqatën Kulturore " SKAMPA " (OJQ) me NIPT: K83526201F.
3. Në Aparatin e Bashkisë do të pakësohet Fondi Rezervë *(me kod 00-01-AF129-604-V491AAA)* në vlerën *1,000,000 lekë* (njëmilion) lekë dhe shtohen në Qëndrën e Kulturës dhe Klubi i Shumësporteve, Programi *(me kod 00-01-AE129-602-V823AAA)* në vlerën *1,000,000 (njëmilion) lekë* .
4. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financë Buxhetit, Qëndra Kulturore dhe Klubi Shumësportësh, Bashkia Lushnjë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Drejtoria e Financës
Ervisa Çuko

Q.K.K.S
Brisida Dervishi

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjja Kongresi Lushnjes Tel:+355 35 222139 Email:bashkia_lushnje@yahoo.com